

20151123420

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 pika 6 dhe në lidhje me nenin 25 paragrafi 4 nga Ligji për Bankën popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12 dhe 43/14), Këshilli i Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

VENDIM PËR KUSHTET DHE MËNYRËN E FURNIZIMIT ME KARTËMONEDHA DHE MONEDHA

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Banka popullore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) është përgjegjëse për furnizimin me kartëmonedha dhe monedha (në tekstin e mëtejshëm: paratë e gatshme) të cilat janë mjet ligjor për pagesë në Republikën e Maqedonisë.

2. Furnizimi me paratë e gatshme kryhet me anë të tërheqjes së kartëmonedhave dhe monedhave nga Banka popullore, përpunimit, paketimit, transportit deri te përdoruesit dhe kthimin e parave të gatshme në Bankën Popullore nga bankat dhe kompanitë për furnizimin me para të gatshme (në tekstin e mëtejshëm: qendrat për para të gatshme).

3. Bankat të cilat kryejnë aktivitetin e furnizimit me para të gatshme janë subjekte juridike të cilat janë themeluar dhe veprojnë në pajtim me Ligjin për banka ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13 dhe 15/15).

4. Qendrat për para të gatshme janë shoqata tregtare të regjistruara në regjistrin tregtar, të cilat i plotësojnë kushtet për furnizimin me para të gatshme të përcaktuara me këtë vendim dhe të cilat me Bankën Popullore do të nënshkruajnë kontratë për furnizim me para të gatshme.

II. KUSHTET PËR FURNIZIM ME PARA TË GATSHME

5. Për kryerjen e furnizimit me para të gatshme, bankat dhe qendrat për para të gatshme duhet të plotësojnë kushtet në vijim:

- në lokalet afariste të kenë thesar dhe/ose arka;
- thesari dhe arka të kenë qasje të lehtë për njësitë e sigurisë në rast të kërcënimit të sigurisë, rast zjarri ose fatkeqësie tjetër elementare;

- përpunimi i parave të gatshme të bëhet në hapësirë të veçantë e cila duhet të jetë e ndarë nga pjesa tjetër e lokalit afarist me material të fortë dhe të plotë dhe me derë që mbyllet;

- hapësira në të cilën kryhet përpunimi i parave të gatshme të jetë në hapësirë ku lëvizja është e kufizuar dhe ku ka kontroll të vazhdueshëm të qasjes, si dhe të jetë e siguruar me sisteme sigurie dhe masa mbrojtëse të cilat nënkuptojnë video-mbikëqyrje të vazhdueshme me regjistrim, sisteme alarmi, sensorë alarmi për paralajmërim të zjarreve në kohë dhe sistemi të kontrollit të qasjes;

- sigurim fizik ditë e natë në hapësirën ku bëhet përpunimi i parave të gatshme;
- të ketë politikë të miratuar për sigurimin e sistemit informativ, e cila së paku ka të përfshirë: dispozitat për parandalimin e zjarrit, sistem për parandalimin e thyerjes/hyrjes me

dhunë, sistem për parandalimin e vjedhjes, si dhe strategji për mbrojtjen e të dhënave në përputhje me dispozitat ligjore;

- të ketë rregullore për punë e cila patjetër të ketë të përfshirë strukturën organizative, procedurë të shkruar dhe shpjegim për mënyrën e kryerjes së shërbimit, mënyrën e kontrollit të rreziqeve në punë, mënyrën e krijimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, të kenë standarde organizative, teknike dhe të sigurisë me qëllim që kryerja e shërbimeve të jetë e suksesshme dhe e sigurt;

- të ketë program për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, i miratuar nga Drejtoria e Inteligjencës Financiare;

- personi përgjegjës dhe të punësuarit në njësinë organizative për furnizimin me para të gatshme të mos jenë të dënuar me vendim gjyqësor të plotfuqishëm për vepër penale, në përjashtim të veprës penale rrezik i sigurisë së trafikut e bërë nga pakujdesi, ose kundër tyre të mos ketë procedurë penale për vepër penale që ka të bëjë me detyrën zyrtare.

Fjala "thesar" për qëllimet e këtij paragrafi do të thotë: hapësirë e veçantë e ndërtuar nga çeliku, betoni ose material tjetër i fortë, me derë thesari me të paktën dy brava të ndryshme, ku secila ka të paktën një çelës rezervë.

Fjala "arkë" për qëllimet e këtij paragrafi do të thotë: hapësirë e mbrojtur nga vjedhjet, ku të paktën një mur i brendshëm i saj ka gjatësi prej një metër, i ndërtuar nga çeliku ose materiali tjetër të fortë, me derë me të paktën dy brava, ku secila ka të paktën një çelës rezervë.

Fjala "çelës" për qëllimet e këtij paragrafi gjithashtu nënkuptohet edhe shifër.

6. Banka Popullore lidhë kontratë për furnizimin me para të gatshme me qendrat për para të gatshme të cilat, përveç kushteve të parapara në pikën 5 të këtij vendimi, plotësojnë edhe kushtet në vijim:

- janë të themeluara me kapital prej 1,230,000.00 denarë,

- ndaj personit juridik të mos jetë iniciuar procedurë për falimentim apo likuidim,

- kryejnë pagesë të rregullt të tatimeve dhe kontributeve në Drejtorinë e të hyrave publike,

- themeluesit e qendrave për para të gatshme të mos jenë të dënuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor për vepër penale, në përjashtim të veprës penale rrezik i sigurisë së trafikut e bërë nga pakujdesi, ose kundër tyre të mos ketë procedurë penale për vepër penale që ka të bëjë me detyrën zyrtare.

Qendrat për para të gatshme janë të detyruara ti përmbushin kushtet e përcaktuara para nënshkrimit të kontratës për furnizim me para të gatshme me Bankën Popullore.

III. MËNYRA E FURNIZIMIT ME PARA TË GATSHME

7. Bankat të cilat tërheqin para të gatshme nga Banka Popullore paguajnë mjete financiare nga llogaria e tyre nëpërmjet Sistemit të Pagesave Ndërbankarë të Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: MIPS) në llogari të veçantë të Bankës Popullore në shumën që ata dëshirojnë ta tërheqin.

Bankat të cilat kthejnë para të gatshme, për shumën e parave të kthyera, marrin pagesa përmes MIPS në llogaritë e tyre nga Banka Popullore.

Qendrat për para të gatshme, pagesën dhe pranimin e mjeteve financiare në rastet nga paragrafët 1 dhe 2 të kësaj pike e bëjnë nëpërmjet llogarive të tyre bankare.

8. Në rast se në qendrat për para të gatshme iniciohet procedurë për falimentim dhe/ose likuidim, Banka Popullore i tërheq paratë e gatshme të tërhequra, dhe në llogaritë e

qendrave për para të gatshme në falimentim gjegjësisht likuidim, paguan shumë të parave në vlerë të shumës së parave të gatshme të tërhequra.

IV. KONTROLLI

9. Banka Popullore kontrollon përmbushjen e kushteve të përmendura në pikën 5 të këtij vendimi.

V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

10. Guvernatori i Bankës Popullore miraton Udhëzime për përcaktimin e mënyrës dhe procedurës së furnizimit me kartëmonedha dhe monedha.

11. Bankat janë të obliguara të harmonizohen me kërkesat e përcaktuara në pikën 5 të këtij vendimi në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

12. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi për furnizimin e bankave me kartëmonedha dhe monedha ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 60/11).

13. Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

V. nr. 02-15/VII-3/2015
25 qershor viti 2015
Shkup

Guvernator
dhe Kryetar i Këshillit
të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë,
Dimitar Bogov